



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1574/4 prot.

Datë 28.07.2022

V E N D I M

Nr. 725/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve Teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Llazo” shpk & “Gener 2” shpk si dhe operatorëve ekonomikë “AlbTiefbau” shpk, “AlkoImpex” shpk & “Arkonstudio” shpk, “Vëllezrit Hysa” shpk, “Salillari” shpk & “Zdravo” shpk, “G.P.G. Company” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-32089-06-07-2022, me objekt: “Rehabilitimi i Përroit Lushnjë dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”, me fond limit 323.814.206leke pa tvsh, zhvilluar me datë 23.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Llazo” shpk & “Gener 2” shpk
Bishqethem1, Rruga “Kemishtaj”, Lushnjë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Rruga “M.Gjollësja, ish-Godina ISTN (pranë IKMT), Tiranë

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “AlbTiefbau” shpk
Lagjja Qemal Stafa, Rruga Studenti, Sheshi 2-Prilli,
pallati Fishta 2, zona kadastrale 8591, nr pasuri
Shkodër

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “AlkoImpex”
shpk & “Arkonstudio”shpk
Rruga: Reshit Petrela, Kompleksi Usluga, kati i 8,
pranë stacionit të trenit, Tiranë

Operatori ekonomik “Vëllezrit Hysa” shpk
Fshati Banjë e Re, Klos, Bashkia Cerrik, buzë lumit
Devoll, 500 m nga ura mbi lumin Devoll, zona
kadastrale Klos Elbasan Klos, Banjë

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Salillari” shpk
& “Zdravo” shpk
Lagjja Vorë, Rruga e Vjetër , Vorë Marikaj, Km 1,
Godina katër katëshe, Kati i tretë, Nr.5, Vorë Tiranë

Operatori ekonomik “G.P.G. Company” shpk
Lagjja 18 Tetori, godinë 1 katëshe, tek nyja e
prodhimit Asfalt Betonit, pranë Rotondos së Plukut
Lushnjë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë
19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i
Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë
13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për
organizimin dhe funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me
shkrim e pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.06.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-32089-06-07-2022, me objekt: “Rehabilitimi i Përroit Lushnjë dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”, me fond limit 323.814.206leke pa tvsh, zhvilluar me datë 23.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 23.06.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 07.07.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave.

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 12.07.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 20.07.2022 BOE Llazo” shpk & “Gener 2” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Llazo” shpk & “Gener 2” shpk si dhe operatorëve ekonomikë “AlbTiefbau” shpk, “AlkoImpex” shpk & “Arkonstudio” shpk,

“Vëllezrit Hysa” shpk, “Salillari” shpk & “Zdravo” shpk dhe “G.P.G. Company” shpk, si dhe shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertave të paraqitura operatorët ekonomikë “AlbTiefbau” shpk, “AlkoImpex” shpk & “Arkonstudio” shpk, “Vëllezrit Hysa” shpk, “Salillari” shpk & “Zdravo” shpk, “G.P.G. Company” shp

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1574/2 prot datë 21.07.2022

II.7. Me shkresën nr. 2011/2 prot, datë 25.07.2022 protokolluar me tonën me nr.1574/3 datë 27.07.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga BOE Llazo” shpk & “Gener 2” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur refuzimi i ankesës për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në datën 08.06.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-32089-06-07-2022, me objekt: “Rehabilitimi i Përroit Lushnjë dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”, me fond limit 323.814.206leke pa tvsh, zhvilluar me datë 23.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

III.1.1. Në datën 23.06.2022, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.2. Në datën 07.07.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 12.07.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 20.07.2022 BOE “Llazo” shpk & “Gener 2” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit

kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Llazo” shpk & “Gener 2” shpk si dhe operatorëve ekonomikë “AlbTiefbau” shpk, “AlkoImpex” shpk & “Arkonstudio” shpk, “Vëllezrit Hysa” shpk, “Salillari” shpk & “Zdravo” shpk dhe “G.P.G. Company” shpk, si dhe shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertave të paraqitura operatorët ekonomikë “AlbTiefbau” shpk, “AlkoImpex” shpk & “Arkonstudio” shpk, “Vëllezrit Hysa” shpk, “Salillari” shpk & “Zdravo” shpk, “G.P.G. Company” shp

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1574/2 prot datë 21.07.2022

III.1.6. Me shkresën nr. 2011/2 prot, datë 25.07.2022 protokolluar me tonën me nr.1574/3 datë 27.07.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga BOE Llazo” shpk & “Gener 2” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur refuzimi i ankesës për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

III.1.7. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.8. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.9 Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit

ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin,*

mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.11. Në interpretim të dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, **është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.** Në rastin konkret referuar verifikimeve në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 12.07.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues në rastin konkret ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” KPP gjykon se llogaritja e afatit të ankimit pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit nga autoriteti kontraktor dhe përfundon në ditën e 7-të. Ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datë 20.07.2022 nga BOE ankimues konsiderohet e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar kështu ankimuesi *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së

prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me argumentat e parashtruara në ankesë nga ana e BOE ankimues sa i takon problematikës së shfaqur me sulmin kibernetik i cili pasoi me mbylljen e shërbimeve në portalet kryesore që varen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si dhe me mungesën e informacionit të pretenduar sa i takon mënyrës së vazhdimit të procedurave të nisura , KPP sqaron se:

Në datën 18.07.2022 me Urdhërin nr.1537 prot “Për marrjen e amsave për njoftimin e autoritetive kontraktore , operatorëve ekonomikë dhe subjekteve të interesuara lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik për shkak të situatës së krijuar si rezultat i sulmit kibernetik ndaj shërbimeve publike online dhe faqeve të tjera qeveritare” si dhe 1538 prot “Njoftim mbi mënyrën e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik deri në rikthimin e shërbimeve publike online” të Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, është sqaruar në mënyrë të detajuar mënyra e paraqitjes së ankesave dhe trajtimit të tyre nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Akoma më tej vetë ankimuesi në parashtrimet në ankesë pranon se është bërë njoftim në faqen e një prej gazetave shqiptare sesi do të vazhdonte procedura e ankimimit pranë KPP dhe vënia në dispozicion e linkut përkatës për cdo sqarim të mundshëm. Sa i takon pretendimit të ankimuesit se adresat e emailit të vëna në dispozicion nga Komisioni nuk funksiononin KPP sjell në vëmendje se vetë ankimuesi ka pasur akses në adresat e emailit të Komisionit dhe ka përdorur këtë linjë komunikimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se argumentat e sjella nga ana e BOE ankimues lidhur me mungesën e informacionit lidhur me ecurinë e procesit nuk qëndrojnë dhe ky i fundit ka pasur në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të lejuara ligjore.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Llazo” shpk & “Gener 2” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-32089-06-07-2022, me objekt: “Rehabilitimi i Përroit Lushnjë dhe rikualifikimi urban i zonave rreth tij”, me fond

limit 323.814.206leke pa tvsh, zhvilluar me datë 23.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “Llazo” shpk & “Gener 2” shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri